Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01 - 785
Datë 31. 12.2018

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 28.12.2018 nxjerr këtë:

VENDIM

1. Validohet dhe akreditohet Italian Beauty Cosmetics- N.Sh (IBC), me adresë rruga Rexhep Krasniqi, blloku A1-1, Prishtinë, për periudhën 28.12.2018 deri 28.12.2021 me kualifikimet:

   1.1. Manikyrist / Manikyriste, Niveli III sipas KKK me 5 kredi të AAP.

   1.2. Pedikyrist / Pedikyriste, Niveli III sipas KKK me 5 kredi të AAP.

Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet nga Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi Akreditimin e institucionit i cili ofron dhe/ose vlereson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të cilat rekomandime janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për Validim të kualifikimit/modulit; Aplikacioni për Akreditim i institucionit ofrues dhe/ose Vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit; vizita në institucionin ofrues/ aplikues dhe dokumentet tjera shtesë, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

2. Vendimi i dërgohet:

- Italian Beauty Cosmetics- N.Sh (IBC); dhe
- Arkivit të AKK

Violeta Dema
Kryetare e KD të AKK